



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 31, datë 14.02.2019

MBI

NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË KRYEINSPEKTORIT TË ISH KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKESËS OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 14.02.2019, bazuar në nenin 62, pika 13 dhe 14 e ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 121, 122 dhe 134 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke mbajtur parasysh situatën e krijuar në Këshill nga depozitimi i një numri të madh ankimesh kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari,

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, të depozituara këto në zyrën e protokollit të Këshillit.
2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, dy anëtarë jo gjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar, të cilët zgjidhen me short në mbledhjen plenare të Këshillit, ndërsa kryetari i komisionit zgjidhet nga anëtarët e tij me propozim të Kryetarit të Këshillit.
3. Komisioni i Përkohshëm shqyrton të gjitha ankimet kundër vendimit të ish Kryeinspektorit të KLD-së, për arkivimin e ankesës, për arkivimin e ankesës pas verifikimit shtesë të saj, dhe për mbylljen e hetimit ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit ose pushimin e tij.
4. Shqyrtimi i ankimeve nga Komisioni i Përkohshëm do të bëhet sipas radhës duke marrë parasysh datën e regjistrimit të tyre në regjistrin e protokollit.
5. Komisioni i Përkohshëm dokumenton çdo veprim për shqyrtimin e ankimeve me procesverbal. Komisioni asistohet nga nëpunës të administratës të caktuar nga Kryetari i Këshillit.
6. Komisioni i Përkohshëm vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve. Vendimi është përfundimtar dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit, siç është rënë dakord.

7. Komisioni i Përkohshëm pas shqyrtimit të ankimit, në përfundim të procesit, vendimmarrjen në lidhje me të, duhet t'ia njoftojë ankuesit, magjistratit dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.
8. Kohëzgjatja e veprimtarisë së këtij komisioni të përkohshëm duhet të jetë deri në shqyrtimin e të gjitha praktikave lidhur me ankimet kundër vendimit të Kryeinspektorit të ish KLD-së, parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi.
9. Shorti për zgjedhjen e anëtarëve të këtij komisioni, në funksion të pikës 2 të këtij vendimin, organizohet në 1 kuti/vazo transparente në të cilën vendosen goglat të cilat përmbajnë shiritat e letrës me togfjalëshat “anëtar i komisionit” dhe “jo anëtar i komisionit”. Kryetarja e Këshillit nuk është pjesë e shortit.
10. Hedhja e shortit bëhet sipas procedurës dhe radhës së mëposhtme:
 - a) Përzgjedhja e anëtarëve jo gjyqtarë - Në një vazo transparente futen 4 gogla të njëjta, sa është numri i anëtarëve jo gjyqtarë të mbetur, pas veçimit nga ky proces të Kryetares. Në dy prej goglave futet nga një shirit letre me togfjalëshin “anëtar i komisionit” dhe në dy goglat e tjera futet nga një shirit letre me togfjalëshin “jo anëtar i komisionit”. Anëtarët jo gjyqtarë të Këshillit, tërheqin me radhë nga një gogël secili, duke lexuar me zë të lartë përmbajtjen e shënimit e duke e treguar këtë para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve. Në përfundim, nga ky prezantim, dy anëtarë jo gjyqtarë do të jenë anëtarë të komisionit.
 - b) Përzgjedhja e anëtarëve gjyqtarë - Në një vazo transparente futen 6 gogla të njëjta, sa është numri i anëtarëve gjyqtarë. Në një prej goglave futet një shirit letre me togfjalëshin “anëtar i komisionit” dhe në pesë goglat e tjera futet nga një shirit letre me togfjalëshin “jo anëtar i komisionit”. Anëtarët gjyqtarë të Këshillit, tërheqin me radhë nga një gogël secili, duke lexuar me zë të lartë përmbajtjen e shënimit e duke e treguar këtë para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve. Në përfundim nga ky prezantim një anëtar gjyqtar do të jetë anëtar i këtij komisioni.
11. Komisioni miraton rregulla lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tij.
12. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR